



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 1847/3 Prot.

Tiranë, më 08/1 /2014

V E N D I M  
Nr. 01, datë 08/01/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "ALIU ROAD HOUSE" sh.p.k Elbasan.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr.254 datë 05.12.2013 është ushtruar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit "ALIU ROAD HOUSE" sh.p.k, me adresë, lagjja "Beqir Dardha", pallati 41/16, pranë Pedagogjikes Elbasan, NIPT: K83211201N, me objekt:

- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 21).

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ, si dhe provat e administruara vëren se:

1. Subjekti "ALIU ROAD HOUSE" sh.p.k, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij në fushën e tregtimit të mallrave industriale dhe ushqimore në qytetin e Elbasanit, mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategoritë "klientë" dhe "punonjës". Bazuar në nenin 3 pika 5 e ligjit nr. 9887 datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar...(5)... "Kontrollues" është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj", subjekti juaj është kontrollues i të dhënave personale.

Në nenin 21 pika 1 e këtij ligji përcaktohet se... "Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë". Neni 22 i këtij ligji saktëson se ç'farë përmban njoftimi i cili duhet të dorëzohet pranë Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për zbatimin e detyrimit të kontrolluesit për të njoftuar, nga ana e Komisionerit është dërguar pranë jush shkresa me nr. 430 prot, datë 19.01.2011 me anë të së cilës ju është

dhënë një informacion i plotë lidhur me këtë detyrim ligjor, si dhe janë dhënë të gjitha shpjegimet e duhura për plotësimin e formularit të njoftimit. Për plotësimin e këtij detyrimi ju është lënë si afat data 18.02.2011. Kjo shkresë është dërguar pranë jush përmes shërbimit postar dhe nuk rezultoi e kthyer prej saj.

2. Deri në momentin e kryerjes së inspektimit datë 10.12.2013 rezultoi se ju si kontrollues nuk e keni kryer këtë detyrim ligjor, duke mos zbatuar nenin 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Ky fakt është pranuar nga ana juaj në procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur në këtë rast. Në këtë proces verbal ju si kontrollues deklaroni se "nuk jeni të informuar për këtë detyrim ligjor dhe kërrojmë përsipër plotësimin e këtij detyrimi". Gjatë inspektimit ju është shpjeguar edhe njëherë se ç'farë detyrimesh ligjore keni lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, si dhe ju është kërkuar të plotësoni menjëherë njoftimin dhe ta dërgoni pranë Autoritetit të Komisionerit.

3. Nga koha e informimit me anë të shkresës sensibilizuese (19.01.2011), si dhe nga koha e kryerjes së inspektimit administrativ (10.12.2013), keni pasur kohë të mjaftueshme në dispozicion për të plotësuar formularin e njoftimit, duke kryer kështu këtë detyrim që kërkon ligji. Mospërbushja e këtij detyrimi është parashikuar si shkelje administrative në nenin 39/1/d të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, sipas të cilit... "d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë", prandaj ndaj subjektit tuaj duhet të aplikohet dënimi me gjobë, masa e të cilës lidhet me shkallën e njohjes dhe mënyrën e zbatimit të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar nga ana juaj si kontrollues.

Gjithashtu, bazuar në nenin 25 të Ligjit, kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit. Në këto kushte e konsiderojmë shkelje përpunimin pa njoftuar e pa u regjistruar më parë në Regjistrin Qendror të Subjekteve Kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit. Fakti që bërja publike, bazuar në nenin 26/2 të ligjit, është penguar për shkak të mos njoftimit të përpunimit/ëve që ju realizoni, mund të ketë penguar referencat e mundshme që subjektet specifike që ju u përpunoni të dhënat mund të kishin bërë te gjendja e përpunimit/ëve që ju realizoni.

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 21-23, 30/2, 39/1.4; 40 e 41, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 107-109 të K.Pr.Administrative dhe Nenit 18/a, e të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative":

## V E N D O S A

1. Dënimin e kontrolluesit "ALIU ROAD HOUSE" sh.p.k, me gjobë 30000 (tridhjetë mijë) lekë, për mos plotësim të detyrimit për njoftim në zbatim të nenit 21 ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm të realizohet brenda një afati kohor prej 7(shtatë) ditësh, nga momenti i marrjes në dijeni të këtij Vendimi.
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot me datë 08/01/2014.

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

